

# DITA E SHKOLLËS SHQIPE



## E DREJTA E SHKOLLIMIT NË DEMOKRACI

FLORENT (14), RIZAH (15), ARBESA (14), ARIZANA (14), KALTRINË (14), ELONË (14) ,ELJETA (15)



### Ju ftojmë ta lexoni këtë artikull, të cilin e kemi shkruar me shumë dashuri

Në demokraci liria, barazia, të drejtat e njeriut, toleranca, etj., janë elemente shumë të rëndësishme. Grupi ynë sot pati mundësi të diskutoj rreth demokraciasë dhe të drejtave tona si fëmijë. Këto të drejta janë: e drejta e shkollimit, e drejta e shprehjes së mendimit, e drejta e familjes, e drejta e lojës, etj. Jemi shumë të lumtur që të gjithë fëmijët i kanë këto të drejta, e posaçërisht të drejtën e shkollimit.

Pasi që sot është një ditë shumë e veçantë, 7 marsi, Dita e Mësuesit, në këtë artikull po shkruajmë rreth kësaj dite dhe rëndësisë së saj. Dituria është dritare e hapur e suksesit në jetë. Për të pasur suksesin duhet të marrim dije duke mësuar dhe duke qenë të përkushtuar në mësim. Këtë dije neve na jep mësuesi/ja, prindi ynë i dytë. Më 7 mars 1887 në Korçë, u hap shkolla e parë shqipe me mësuesin Pandeli Sotiri. Hapja e kësaj shkolle, për nga karakteri kishte tipare demokratike. Kjo sepse në të mësonin fëmijët e të gjitha shtresave, të varfër e të pasur. Hapja e një shkolle të tillë ishte hap i madh për kombin shqiptar. Prandaj, ngjarja e tillë festohet edhe sot e kësaj dite. Shumë nxënës për të shprehur respektin e tyre ndaj mësuesve, në këtë ditë festive, iu bëjnë dhurata mësuesve, si shenjë falenderimi për kontributin e tyre.

Ne si nxënës, duke qenë e ardhmja e vendit, duhet t'i bëjmë krenarë mësuesit tanë, duke mësuar sa më shumë dhe duke qenë nxënës të përgjegjshëm.



Vizatimet janë bërë nga ne të dy



Roli ynë ishte të shprehim idetë tona rreth artikullit




Ne jemi ato të cilat e kemi shkruar artikullin në laptop



Shkolla, si vend i dijes, vendi ku ne mësojmë gjëra të ndryshme. Vetëm duke mësuar, duke lexuar libra të ndryshëm, ne si fëmijë mund të ndikojmë shumë në zhvillimin e shtetit tonë



Nxënësit e klasës sonë, sot patëm rastin të jemi gazetarë të Kuvendit, duke shkruar artikuj të ndryshëm rreth demokracisë. Përveç kësaj ne zhvilluam edhe aktivitete të tjera, prandaj kjo ditë do të jetë e paharruar për neve



Në demokraci roli i qytetarëve është jashtëzakonisht i rëndësishëm. Duke kontribuar në vend, duke marrë pjesë vullnetarisht në organizime të ndryshme të cilat kanë qëllim përmirësimin e vendit, ne bëhemi qytetarë aktiv

## RREGULLAT NË SHTETIN TONË

ALTINA (15), AULON (14), HALIME (16), FLORJAN (14), BLEONA (15), RRUSTEM (14), FLOTA (14)



Le të shikojmë se si ligjet e rregullojnë jetën tonë dhe se sa të rëndësishme janë ato për ne

### Ligjet miratohen nga deputetët tanë

Jetojmë në një shtet, i cili ka një ajër relativisht të ndotur. Themi relativisht, sepse në disa pjesë të Kosovës, ajri është më i ndotur. Këto vende janë të ngarkuara me ndërtesa të shumta, si dhe me vetura të vjetra. Por, kemi edhe vende malore, ku secili prej nesh do të dëshironte të jetonte. Ose të paktën, ta kalonte kohën aty.



Ne si të rinjë, e kemi diskutuar shumë shpesh çështjen e materialeve të ndyshme të plastikës dhe materiale të tjera, siç janë: shishet e plastikës, kanaçet nga metali dhe shishet nga qelqi. Këto janë disa prej materialeve të cilat kanë mundësi të përpunohen, por së pari duhet të vetëdijësohemi ne si qytetarë të Kosovës. E si arrihet kjo, ne e kemi menduar një plan: Kuvendi i Kosovës duhet ta vë në fuqi ligjin i cili rregullon këtë çështje, duke iu dhënë mundësi qytetarëve t'u kthehet

një shumë e parave nëse ata i kthejnë shishet dhe kanaçet e zbrazëta në dyqanet ku i kanë blerë ato. Ligji për të cilin shkruajtëm më lart, do të na ndihmonte shumë në mbrojtjen e ambientit, por kemi edhe ligje të tjera të cilat na mbrojnë nga rreziqe të tjera p.sh. Ligji për Sigurinë në Komunikacionin Rrugor. Ligjet janë rregulla të shkruara të cilat duhet të respektohen nga të gjithë ne. Ato mund të jenë edhe mësim për ne. Nëse ne e shkelim një ligj, ne pa dyshim se dënohemi. Mirëpo, ana pozitive është që ne nuk e përsërisim atë gabim prapë, sepse njeriu duhet të mësojë nga gabimet. Të drejtën për të propozuar një projektligj e kanë deputetët, Presidenti, Qeveria, dhe 10.000 qytetarë. Por miratimin e ligjeve, e bëjnë deputetët me anë të votave të tyre. Ne si grup, i cili shkroi për ligjet, e kuptuam rrënjën se pse duhet t'i respektojmë ato. Tani ju mbetet edhe juve të bëni të njëjtën gjë.



Ne e kemi fuqinë, sepse ne jetojmë në demokraci

# ZGJEDHJET - ZEMRA E DEMOKRACISË

RINESA (14), SAFET (14), ARDIAN (14), ALTIONA (14), FLORIJE (15), ARDIT (14)



Përmes këtyre vizatimeve kemi dashur të tregojmë që me anë të zgjedhjeve ne i zgjedhim përfaqësuesit tanë, qoftë ata në nivel lokal, qoftë në nivel qendror. Këta përfaqësues i zgjedhim me anë të votave të lira dhe të pa imponueshme

Si çdo ditë tjetër, edhe sot ditën e filluam me zgjedhje. Është për t'u habitur fakti që çdo ditë e gëzojmë dhe e jetësojmë këtë të drejtë që ne e kemi. Ju, të dashur lexues, e dini që ne jemi nxënës të shkollës fillore dhe ndoshta u menduat pak se si ne, në këtë moshë kemi të drejtën e zgjedhjes. Ashtu është, dita jonë çdo herë fillon me zgjedhje. Në këtë mënyrë filloi diskutimin në grup shoku ynë Safeti. Ai po ashtu na tregoi se kur ne, qytetarët themi se kemi bërë një zgjedhje. Kur në dispozicion kemi më shumë se dy opsione dhe ne duhet ta zgjedhim njërin prej tyre për ndonjë çështje të caktuar, atëherë themi se kemi bërë zgjedhje. Kjo është përditshmëria jonë si nxënës, por edhe si qytetarë. Zgjedhjet që i bëjmë në përditshmëri nuk kanë ndikim aq të madh sa kanë zgjedhjet që i bëjmë si nxënës,

në shkollë për shembull. Kur e zgjedhim kryetarin e klasës, jemi shumë më të kujdesshëm, sepse kryetari i klasës është përfaqësuesi ynë. Ashtu siç edhe popullin e përfaqësojnë deputetët. Zgjedhja si e deputetëve, kryetarit të komunës dhe asamblistëve bëhet në të njëjtën mënyrë qysh e zgjedhim edhe ne kryetarin e klasës. Pra, me anë të votave të lira. Por jo të gjithë këta përfaqësues që i cekëm zgjedhjen në të njëjtat zgjedhje. Deputetët i zgjedhim në zgjedhjet qendrore, kurse kryetarin e komunës dhe asamblistët në zgjedhjet lokale. Kuptohet, të drejtë për të marrë pjesë dhe për t'i zgjedhur përfaqësuesit tek të dy llojet e zgjedhjeve e kanë personat mbi moshën 18 vjeçare. Vota e secilit ka vlerë dhe rëndësi. Kjo është arsyeja pse ne kërkojmë nga ju që gjithmonë të votoni.



Gjatë realizimit të punës në grup të vogël



Autorët e artikullit



## IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI  
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA  
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



**ERSTE Stiftung**

Redaktohet nga  
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit  
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga  
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:  
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Salih Bytyqi“  
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: IX-3  
Website: www.demos-ti.org Vendi: Shkozë, Malishevë